



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 132, datë 23.12.2013

**PËR
MIRATIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DEVON” SH.A. PËR USHTRIM
VEPRIMTARIE SI BROKER NË SIGURIME**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 6/dh, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të pikës 1, të nenit 81, të Ligjit nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” si dhe të VKM-së nr. 79, datë 28.01.2008 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave për licencimin e ndërmjetësve në sigurime dhe të rregullave për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tyre, si dhe rastet e refuzimit të licencës”, me propozim të Departamentit të Licencimit dhe Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e shoqërisë “DEVON” sh.a., si “Broker në sigurime” për klasat e Jetës, për një periudhë pa afat.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Enkelelda SHEHI